

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Tonka Berishaj dhe Fllanza Kadiu, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionalë, Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.T., nga Kaçaniku, për shkak të veprave penale-mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e të akuzuarit N.T. dhe ankesën e mbrojtësit të tij av. H.L., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr. 320/16 të datës 13 shkurt 2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datën 28 mars 2017, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohen si të pabazuara ankesa e të akuzuarit N.T. dhe ankesa e mbrojtësit të tij, av. H.L., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr. 320/16 të datës 13 shkurt 2016, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr. 320/16 të datës 13 shkurt 2016, të akuzuarin N.T. e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 1 të KPRK-së dhe i ka përcaktuar dënimet: për veprën penale nga neni 374 par. 1 të KPRK - dënim me gjobë në shumë prej 400 € dhe për veprën penale nga neni 365 par. 1 të KPRK dënim me kushte- dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nuk krye vepër tjetër penale dhe e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë prej 400 € dhe dënim me kushte- dënim me burgim në

kohëzgjatje prej 180 ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nuk krye vepër tjetër penale.

I akuzuari është obliguar që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-I akuzuari për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë duke e zbutë dënimin për veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 1 të KPRK ndërsa të lirohet nga dënimi për veprën penale nga neni 374 par. 1 të KPRK, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit N.T., av H.L., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarit ti shqiptojë një dënim unik më të butë.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën PPA/I.nr 139/17 të dt. 15 mars 2017, ka propozuar që të refuzohen ankesat e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën palët nuk janë njoftuar sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me aktgjykim ku është shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim me kusht, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

I akuzuari N.T. në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par 1.9 të KPPK-së, sepse i akuzuari i thirrur për ta pranuar fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës. Në fakt, i akuzuari pretendon se ai e ka pranuar fajësinë vetëm për veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 1 të KPRK e jo edhe për veprën penale nga neni 374 par. 1 të KPRK, si gabimisht ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar. Gjithashtu pretendon se është bërë gabim në datat e marrjes së aktgjykimit sepse në dispozitiv konstatohet si datë e marrjes së vendimit 13.02 2016 ndërsa në fund të arsyetimit të aktgjykimit dt. 13.02.2017.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara për këto arsye:

Nga shkresat e lëndës, konkretisht nga shikimi i procesverbalit të shqyrtimit fillestar i mbajtur me 13 shkurt 2017, rezulton se gjykata e shkallës së parë shqyrtimin fillestar e ka mbajtur duke i respektuar të gjitha kërkesat nga neni 245 të KPPK; në shqyrtim ishin të pranishëm Prokurori, i akuzuari N.T. dhe mbrojtësi i tij av. H.L.; i akuzuari është njoftuar me të gjitha të drejtat ashtu si parashikohet me dispozitën e nenit 246, par. 1 të KPPK, pastaj ka vazhduar me përmbushjen e kërkesave tjera sipas të njëjtës dispozitë ( paragrafi 2,3 dhe 4): Në faqen tre (3) të procesverbalit të shqyrtimit fillestar qartë është konstatuar deklarimi i të akuzuarit N.T. lidhur me aktakuzën dhe pranimin e fajësisë për veprat penale ku taksativisht konstatohet: 'I pandehuri N.T. deklaroi: se e ka kuptuar në tersi aktakuzën e lexuar dhe se nuk ka nevojë për shpjegime shtesë, ndërsa veprat penale të cilat më vihen në barrë, dhe atë veprën penale nën dispozitiv II dhe III, dhe atë mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 1 të KPRK-së, e pranoj fajësinë për to dhe sepse i kam kryer, e ndiej vetën fajtor dhe kërkoj falje'', pastaj vazhdon me deklarimin se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare pa imponim dhe se i ka kuptuar pasojat e pranimin të fajësisë. Gjithashtu i akuzuari deklarimin lidhur me fajësinë e ka bërë në praninë e mbrojtësit të tij i cili po ashtu është pajtuar me pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Prandaj nga këto arsye nuk qëndron pretendimi i të akuzuarit se ai e ka pranuar fajësinë vetëm për një vepër penale dhe atë nga neni 365 par. 1 të KPRK, por pranimin e fajësisë e ka bërë për gjitha pikat e akuzës në pajtim me dispozitat e nenit 246 dhe 248 KPPK-së dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza.

Sa i përket pretendimit ankimor se në aktgjykim janë të konstatuara datat e ndryshme, kjo Gjykatë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konkretisht procesverbalit të shqyrtimit fillestar, por edhe shkresave tjera si flet kthesat e thirrjeve për prezencën e palëve në shqyrtim, vërtetohet se data e saktë e marrjes së aktgjykimit të ankimuar është 13.02.2017 ( si në faqen 4 të aktgjykimit të ankimuar) dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në këtë rast kemi të bëjmë me një gabim teknik.

Prandaj, nga arsyet e theksuara si më lartë, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të akuzuarit janë të pabazuara dhe aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkeljet esenciale të pretenduara e as me shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt i vlerësimit të kësaj Gjykate, ngase në këtë drejtim nuk ka pasur ankesë e as që lejohet ankesa pasi që të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë - neni 383 par. 2 të KPPK-së, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit theksohet se

grykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit nuk ka arritur që ti vlerësoi dhe ti çmoi të gjitha rrethanat lehtësuese si jetën dhe sjelljet e mëparshme të të akuzuarit, rrethanat personale si ato familjare ashtu edhe gjendjen ekonomike sepse është i papunë dhe nuk ka mundësi që ta paguaj dënimin. Ndërkaq i akuzuari pretendon se grykata e shkallës së parë i ka nënvlerësuar rrethanat e konstatuara lehtësuese prandaj edhe dënimi është shumë i lartë.

Grykata e Apelit gjënë se pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara sepse grykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e dënimit konform nenit 73 të KPK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pendimin e shprehur dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa rrethana renduese nuk gjeti. Vlerësimin e tillë të rrethanave për matjen e dënimit si të drejtë e pranon edhe Grykata e Apelit, e cila gjen se dënimi me gjobë i shqiptuar ndaj të akuzuarit, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së.

Për një dënim më të butë, për çka pretendon i akuzuari dhe mbrojtësi i tij nuk janë përmbushur kushtet ligjore, meqë rrethanat të cilave u referohen në ankesë nuk e kanë peshën e tillë që do të arsyetonin një dënim më të ultë ndaj të akuzuarit.

Për këto arsye ankesa e të akuzuarit përkitazi me vendimin mbi dënimin u refuzua si e pabazuara.

Nga çka u tha si më lartë konform nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr. 132/2017 i datës 28 mars 2017

Procesmbajtësi:

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit:

Tonka Berishaj\_\_\_\_\_

Fllanza Kadiu\_\_\_\_\_

Kryetari i kolegjit:

Xhevdet Abazi